



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

VENDIMET E BORDIT TË FBK-së TË DATËS 23.05.2016

Bordi i Federatës së Basketbollit në mbledhjen e vet të mbajtur më 23.05.2016 ndër të tjera miratoi edhe këto

VENDIME

1. Bordi e cilësoi si shumë të suksesshëm sezonin 2015/16 bazuar në rrjedhën e sezoneve të rregullta dhe garave të plejofit në të gjitha ligat dhe pjesëmarrjes së suksesshme të tri ekipeve kosovare të meshkujve në gara ndërkombëtare.
2. Bordi trajtoi raportet e komesarëve të garave dhe konstatoi se kanë nevojë për plotësime. Bordi i dha komesarëve të garave tri ditë kohë që të përpilojnë raportet e reja dhe ti inkuadrojnë në një raport të vetëm, që më pas do të miratohet nga Bordi me votim elektronik.
3. Bordi u informua për rrjedhën e përgatitjeve të reprezentacioneve të grup moshave të reja për kampionatet evropiane në divizionet përkatëse. Bordi konstatoi telashe në përgatitjet e reprezentacionit U18 të femrave dhe autorizoi trajnerët që punojnë me këtë reprezentacion të ofrojnë informata të detajuara, kurse Bordi do të intervenojë në rast nevojë.
4. Bordi u informua për statusin juridik të lojtarëve nga diaspora që do të garojnë për reprezentacionin e Kosovës.
5. Bordi vendosi që Kuvendi zgjedhor i FBK-së të mbahet më datën 07 qershor 2016, në ora 19:00 në Prishtinë. Për vendin e mbajtjes së Kuvendit delegatët do të informohen me kohë. Bordi e cilësoi datën 07 qershor si më e përshtatshme për duke pasur parasysh aktivitetet e reprezentacioneve të Kosovës gjatë muajve të verës. Informatat për delegatët e Kuvendit zgjedhor do të publikohen në një lajmërim të veçantë në ueb faqen zyrtare të FBK-së.

Erold Belegu

Kryetar,



Federta e Basketbollit e Kosovës

Kosovo Basketball Federation, Lagjja Arbëria, Objekti C2/11, Lokali nr. 4, 10000, Prishtina, Kosovo
ëëë.basketbolli.com, email: info@basketbolli.com, tel: +381 38 704 101; mob: +386 49 738 080



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT



BNP PARIBAS JOINT VENTURE



BAKER TILLY
KOSOVO



TREGTIA
www.tregtia.net

